

**AKT – THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"JULIETTE" SHPK**

Sot me datën 27/07/2021 (dymijë e njëzet e një), unë ortaku themelues :

- **Z.Ervin Xhaferri** I biri I Gani , i datëlindjes 13 Maj 1985, lindur në Bubq dhe banues në Tiranë person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues I Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. Leternjoftimi I50513017S .

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",

Kam vendosur të themeloj *Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar " JULIETTE" SHPK.*

**NENI 1.**  
**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria do të quhet " JULIETTE" SHPK.

**NENI 2**  
**SELIA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të ketë selinë e saj në, "Ndërtesë me nr pasurie 3/226+1-2, zona kadastrale 8270, volum 26, faqe 156,Rruga Pjeter Bogdani,Tiranë " .

**NENI 3**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushën e: "Administrimin dhe shfrytëzimin e restoranteve, bareve, hoteleve, kampeve të pushimit, si dhe cdo mjedis tjetër në të cilën ofrohen pije alkoolike dhe joalkoolike si dhe ushqime. Keshillimin legjislativ, teknik dhe administrativ në fushën e administrimit të bareve, restoranteve dhe turizmit në përgjithësi si dhe cdo fushe tjetër të lidhur me to. Marrjen me qira, administrimin dhe ose marrjen me koncesion të shoqërive të këtij sektori apo dhe sektorëve të tjerë të lidhur me të. Shoqëria mund të kryejë dhe veprimtari të tjera ndihmëse të cilat mbështesin arritjen e qëllimit të saj kryesor në përputhje me legjisllacionin në fuqi."

**NENI 4**  
**KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë "**JULIETTE" SHPK** është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Ky kapital është i ndarë në 1 kuotë, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Kontributi i ortakëve është i ndarë si vijon:

**1.Ervin Xhaferri zotëron 1 kuotë baraz me 100 % të kapitalit.**

#### **NENI 5**

#### **KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

#### **NENI 6**

#### **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Administratori i shoqërisë do të jetë **Z.Darjo Çoçlli, me ID J40709030I**, i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marredhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve,statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

#### **NENI 7**

#### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqëritë Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **NENI 8**

#### **NDARJA E FITIMEVE**

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

#### **Neni 9**

#### **LIKUIDIMI**

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

***NENI 10***  
***MOSMARRËVESHJET***

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Tiranë për zgjidhje.

***ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË***  
***"JULIETTE" SH.P.K***  
***Ervin Xhaferri***

*Ervin Xhaferri* 